



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Emri i Punëtorit Name of Employee	04-03-2021	1	Viti i vitit Year
Emri i Departamentit Name of Department	SKPM&HK	974/2021	Sasia e Reklamës Quantity
			113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.20/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.20/2021 të datës 20.01.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe të cilët i përfaqëson ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.20/2021 e datës 20.01.2021 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Departamentin për Integritet Evropian pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 20.01.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokoll 220/2021 të regjistruar me numër A.nr.20/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në vlerë prej 250 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimin me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 27.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit te Ministria e Punëve të

Brendshme. Këshilli më datë 04.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.


Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 220/2021 të regjistruar me numër A.nr.20/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e marrëdhënies së punës Nr.542 të datës 01.08.2019; Vendimin Nr.08/170 të datës 14.02.2014 dhe Vendimin Nr.03/82 të datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kontratën e marrëdhënies së punës Nr.541 të datës 01.08.2019; Kërkesën për lejimin e pagesës shtesë të datës 12.01.2019; Kërkesën e datës 09.09.2019; Kontratë e marrëdhënies së punës Nr.889 të datës 05.12.2019; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 09.09.2019; Listën e pagave; Ankesën për moszbatimin e vendimit të Qeverisë të datës 18.01.2021 nga ankuesin në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin e datës 19.01.2021 për ankuesit dhe Përgjigjen në ankesë të datës 04.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesit kanë krijuar marrëdhënie punë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për periudhë tri (3) vjeçare, bazuar në Marrëveshjen për Bursë të lidhur në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, kështu që ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër protokoli 542 të datës 01.08.2019 mbanë pozitën e Zyrtarit të Lartë për Koordinim të Politikave, ndërsa ankuesi sipas Kontratës së Punës me numër protokoli 541 të datës 01.08.2019 dhe ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër protokoli 889 të datës 05.12.2019 mbajnë pozitën e Zyrtarit të Lartë për Integritet Evropian në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me datë 20.01.2021 ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në vlerë prej 250 euro në muaj, sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 dhe Vendimit me Nr.08/170 të datës 14.02.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive nga data e themelimit të marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesit për njohjen e kësaj të drejte nuk i janë drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, respektivisht udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim të organit të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesit mund të kontestonin ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për*



Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.* Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesit në këtë procedurë nuk kanë parashtruar fillimisht kërkesë pran organit të punësimit, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.20/2021

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

